



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:049360

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05519999

KF.nr.187/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, gjyqtarja Vera Gashi Bala, me zyrtaren ligjore Arta Hyseni, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit N.SH.T. “Rubin”, me numër fiskal 600191382 dhe seli në Gjakovë, rr. Ismail Qemali nr.111, të cilin me autorizim e përfaqëson A.S. nga Prishtina, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit – objekt kontesti tatim shtesë, vlera e kontestit 13,981.79 €, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik, të mbajtur me datë 15.03.2024 në prani të përfaqësuesit të palës paditëse A.S., e në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit N.SH.T. “Rubin” me seli në Gjakovë, si e bazuar.
- II. ANULOHET vendimi nr.03/2021 i datës 15.02.2021, i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës.
- III. DETYROHET e paditura Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit N.SH.T “Rubin”, me seli në Gjakovë, të ia kthej shumën e paguar më tepër prej 13,981.79 € (trembëdhjetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e një euro e shtatëdhjetë e nëntë cent) me kamatë ligjore në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Financave e Republikës së Kosovës, në lidhje me secilin muajin kalendarik në mes të datës së pagesës, e gjer në pagesën definitive, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi.
- IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi, NSHT Rubin, përmes përfaqësuesit të autorizuar A.S., me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 16.03.2021, ka iniciuar kontestin tregtar-administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr. 03/2021 të datës 15.02.2021 ashtu që e paditura të lirohet nga qarkullimi shtesë që ka rezultuar nga raporti i ri-kontrollit i datës 06.07.2021. Përfaqësuesi i palës paditëse në seancën e datës 15.03.2024 ka precizuar kërkesëpadinë duke kërkuar nga gjykata që ta obligojë të paditurën që të kthej shumën e tatimit të paguar për TVSh për periudhën 06.2009-12.2009 në shumën prej 4,719.03 euro të PD – 2009 në shumën prej 2,191.23 euro TVSH për periudhën 01.2010-09.2010 në shumën prej 5,747.13 euro IS TM2/2009 në shumën prej 881,81 euro si dhe kontributet pensionale TM2/2009 dhe TM4/2009 në shumën prej 442,59 euro të gjitha këto me kamatë prej 8% nga data e pagesës prej 31.08.2017 deri në pagesën definitive. Gjykatës i ka dorëzuar dëshmitë e pagesës të cilat i ka kryer paditësi ndaj të paditurës lidhur me tatimin shtesë. Më tej ka theksuar se e paditura këtë çështje administrative e ka vendosur në kundërshtim me nenin 20 të Ligjit mbi ATK-në 03/L-222, për shkak se ka hapur ri kontrollin jashtë periudhës gjashtë vjeçare. Më tej ka shtuar se gjykatës i është ofruar një opinion ligjor i brendshëm i lëshuar nga vetë e paditura e cila është edhe si provë në shkresat e lëndës ku sqaron se të gjitha tatimet duhet të vlerësohen brenda periudhës gjashtë vjeçare. Gjatë deklarimit ka theksuar se e paditura nuk ka përfillur asnjë vërejtje të aktgjykimit A.nr.1541/17 të datës 17.11.2020, dhe duke mos marrë për bazë këto vërejtje. Po ashtu e paditura edhe në përgjigje në padi provat të cilat i ka ofruar janë prova të cilat janë ofruar nga vet paditësi për të treguar lidhur me kontestin që ka me Doganën e Kosovës sa i përket kontestit të matjes së stokut. E paditura në vitin 2011 ka pasur kontroll për periudhën janar 2005- shtator 2010, në të cilën kontroll nuk është konstatuar se ka një mungesë të tillë të stokut i cili raport është bashkangjitur në shkresat e lëndës. Sa i përket përgjigjes në padi të paditurës ku thirret se ATK në bazë të nenit 19 par 11.1 i Ligjit për ATK-në ka të drejtë që të bëjë ri kontrole në çdo kohë, është fakt që ka të drejtë, mirëpo brenda periudhës gjashtë vjeçare që është paraparë në nenin 20 të Ligjit mbi ATK-në. Përveç saj ri kontrolli lejohet atëherë kur janë zbuluar faktet e reja nga ATK-ja, ndërsa në rastin konkret informatat nga palët e treta nuk janë zbuluar nga ATK, por janë ofruar nga Dogana e Kosovës, të cilat informata për paditësin kanë qenë të pasakta, akoma nuk janë të sakta për faktin se për gjashtë vite paditësi me Doganën e Kosovës ka qenë në procedura administrative dhe gjyqësore për shkak të matjes së stokut. Ku Dogana e Kosovës në fillim ka konstatuar se paditësi deri në vitin 2016 ka tepricë të stokut, ndërsa me vendimin 03.1.1/2017/94 thotë se ka mungesë të stokut, mirëpo verifikimi i stokut

nga matja e vitit 2009 nuk është bërë asnjëherë nga Dogana e Kosovës sipas kërkesave dhe rekomandimeve të gjykatave në kontestin në mes të doganës dhe paditësit, ku është kërkuar që në stok të përfshihen edhe gurët dekorativ dhe të bëhet matja, mirëpo një gjë e tillë nuk është bërë nga Dogana e Kosovës. Më tej shton se po të shikohet ky vendim i doganës është absurd për faktin se citon “nga prokurori i rastit jemi udhëzuar gojarisht që të merret gjendja e prezantuar sipas subjektit në fjalë dhe të merret matja e arit sipas zyrtarëve që kanë qenë në pikën e kontrollit”, kjo do të thotë se vendimi i doganës nuk ka vërtetuar gjendjen faktike të matjes së stokut të arit. Atëherë si mund të merren dy gjendje edhe stoku i paditësit edhe matja sipas Doganës së Kosovës që është bërë në vitin 2019 që është kontestuese. Dogana e Kosovës pas kësaj matje të vitit 2009 ka iniciuar procedurë penale, në vitin kur janë bërë hetime penale janë bërë ekspertiza financiare, ndërsa në vitin 2011 Prokuroria Komunale në Gjakovë pushon hetimet ndaj pronarit të biznesit për shkak se nuk ka shmangie tatimore sipas pretendimeve të doganës për vitet 2005-2010. Andaj prokuroria i ka analizuar edhe raportin e kontrollit të vitit 2011 të vetë të paditurës si dhe ekspertizën financiare të cilat i ka kërkuar vet prokuroria. Gjykatës i ka dorëzuar kopjen e Aktvendimit të Prokurorisë Komunale në Gjakovë si dhe ekspertizën financiare të punuar për Doganën në raport me stokun.

E paditura, në përgjigjen në padi të datës 13.03.2023 ka kundërshtuar në tërësi padinë e paditësit kundër vendimit të DA/ATK duke konsideruar se vendimi i DA/ATK ka mbështetje ligjore dhe faktike dhe është në harmoni të plot me legjislacionin tatimor të aplikueshëm. Tutje ka shtuar se nuk qëndron pretendimi i paditësit se ri kontrolli është kryer pas periudhës 6 vjeçare, pasi që ri-kontrolli është kryer konform nenit 19 par. 11 të Ligjit nr.03/l-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, dispozitë e cila e vërteton ligjshmërinë e vlerësimit tatimor të kryer nga ATK ashtu që bënë përjashtimin e periudhës 6 vjeçare të përcaktuar në nenin 20 dhe atë në rastet kur ATK-ja ka zbuluar fakte dhe provat të reja sipas paragrafit 11 nën par 1 të nenit 19. Tutje ka theksuar se ATK ka vlerësuar informatat nga palët e treta, respektivisht informatat e marra nga Dogana e Kosovës lidhur me mungesën e konstatuar të stokut në sasi prej 3,543.18 ari, gjegjësisht shitje e padeklaruar nga paditësi e cila ATK-në e ka njoftuar përmes listës së distribuimit me referencë 04.1/708 dt.06.12.2016 mbi rezultatin e nxjerrë sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.33/2014 të datës 18.02.2016. Gjykatës i ka propozuar të refuzohet padia e paditësit si e pabazuar dhe të vërtetohet vendimi i ATK-së.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor - publik të datës 15.03.2024, ka administruar provat si

në vijim: Vendim 03/2021 dt. 15.02.2021, Raport i ri kontrollit nr.05/2017 dt. 06.07.2017, Ankesë e dt. 17.07.2017 ,Vendim nr. 263/2017 dt. 09.08.2017, Padi dt. 08.09.2017, Aktgjykim A.nr. 1541/17 dt. 17.11.2020, Opinion ligjor nga Drejtor i Departamentit Ligjor të Ankesave dt. 11.10.2013, Vendim i Doganës nr.03.1.1-2017/94 dt. 26.06.2018, Aktvendim i Doganës nr. 06.1.1.4/1083/2009 dt. 29.04.2016, Aktgjykim A.nr. 33/2014 dt. 18.02.2016, Raport i kontrollit dt. 18.03.2011, Përkujtesat për pagesë nga ATK dhe transaksionet e pagesave në bankë për tatimet të cilat kanë dal si rezultat i kontrollit i datës 06.07.2017, Aktvendim i Prokurorisë Komunale në Gjakovë nr. PP.nr.315/2011 dt. 23.06.2011, Ekspertizë e dt. 23.12.2015, Gjendja SIGTAS-pasqyrat e tatimpaguesit e printuar me dt. 06.03.2023, Procesverbali mbi kundërvajtjen doganore dt. 08.07.2009, Ndalim i përkohshëm nga Dogana e Kosovës, Formular i deklarimit dhe i pagesës së TVSH-së maj 2010 bashkë me DUD-a, Pasqyrë e lëvizjes së arit deri 19.06.2009, Gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve tjera dt. 01.11.2021.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt tregtar administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ, deklarimeve në padi, përgjigjes në padi, shkresat e lëndës, vendimit kontestues, dhe deklarimit në seancën e shqyrtimit gjyqësor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se paditësi me datë 06.07.2017, ka pranuar raportin e kontrollit nga ATK-ja. Nga gjetjet e të njëjtit është konstatuar qarkullim shtesë për TVSH, PD, IS dhe KP. Jo kontestuese mbesin edhe faktet se paditësi, ka ushtruar ankesë në departamentin e ankesave në ATK, e për të cilën ankesë, ATK-ja me datë 09.08.2017, ka marr vendimin nr. 263/2017, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin ka refuzuar kërkesën e subjektin në procedurë, këtu paditësit. Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative – Divizioni Fiskal, me aktgjykimin e datës A.nr.1541/17 ka aprovuar padinë e paditësit të ushtruar për anulimin e vendimit, ashtu që ka anuluar vendimin e ATK-së nr.263/2017 dhe lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditur, duke e obliguar të paditurën që të deklarohet lidhur me faktin se cilat qenkan këto informata apo fakte të reja të pranuar nga Dogana e Kosovës e të cilat nuk kanë qenë të qasshme apo nuk janë ditur më herët, po ashtu ka kërkuar që e paditura të sqaron a ekziston miratimi nga Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së bazuar në evidencë të

dokumentuar duke mbështetur bazën për rihapje dhe cilat janë këto evidenca të dokumentuara, rasti i mbyllur e i ri-hapur për kontroll çfarë gabimi të definuar qartë e material e ka përmbajtur e i cili ka ekzistuar në kohën e kontrollit, dhe në fund nga e njëjta ka kërkuar të aplikoj drejtë dispozitën nga neni 20, i Ligjit nr. 03/L-222. Po ashtu nuk është kontestuese se duke vepruar sipas aktgjykimit të lartcekur e paditura me datë 15.02.2021 ka marrë vendimin kontestues nr.03/2021, ndaj të cilit paditësi ka ushtruar padinë për inicimin e këtij konflikti administrativ. Kontestuese në mes të palëve mbetet e drejta e ATK-së këtu të paditurës, për ri kontroll pas kalimit të afatit prej 6 viteve dhe gjetjet nga raporti i kontrollit bazuar në informtata nga palët e treta, përkatësisht nga Dogana e Kosovës.

Gjykata duke vlerësuar ligjshmërinë e aktit përfundimtar të të paditurës, përkatësisht vendimin kontestues nr. 03/2021, konstaton se e paditura edhe përkundër obligimeve nga aktgjykimi i lartcekur, nuk i ka përfillur vërejtjet e dhëna në të njëjtin, ashtu që në vendimin kontestues ka ritheksuar të gjeturat e njëjta si në vendimin paraprak.

Gjykata përfundimin e tillë të të paditurës e konsideron të paqëndrueshëm dhe të pabazuar në dispozitat ligjore të aplikueshme në legjislacionin tatimor. Gjykata po ashtu vëren se e paditura nuk ka arsyetuar nëse ka pas apo jo miratimin e Drejtorit të përgjithshëm për ushtrimin e ri-kontrollit, ashtu siç edhe ishte udhëzuar me aktgjykimin A.nr.1541/17.

Lejueshmëria e ri-kontrollit është e rregulluar me Ligjin nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, përkatësisht nenin 19, i cili në paragrafin 11 përcakton “*Administrata Tatimore nuk do të ri-kontrollojë një periudhë tatimore që përfshinë llojin e njëjtë të tatimit që më herët është kontrolluar e për të cilën është lëshuar një njoftim vlerësim nga administrata tatimore, ku ri-kontrolli i tillë do të rezultojë në një rezultat të pafavorshëm për tatimpaguesin, përveç në rrethanat vijuese: 18 11.1. kur të jenë zbuluar faktet e reja nga administrata tatimore të cilat nuk janë ditur dhe nuk kanë mundur arsyeshëm të dihen, në kohën e kontrollit dhe moshapja e rastit do të ishte mungesë serioze administrative; 11.2. kur ka evidencë për mashtrim, shpërdorim, marrëveshje të fshehtë, fshehje e provave apo keqinterpretim i fakteve materiale; 11.3. rasti i mbyllur që përmban një gabim të definuar qartë e material i bazuar në një pozitë të vendosur të administratës tatimore i cili ka ekzistuar në kohën e kontrollit. Çdo rihapje e një kontrolli të mbyllur i nënshtrohet miratimit nga Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së bazuar në evidencë të dokumentuar duke mbështetur bazën për rihapje*”. Ndërsa lidhur me kufizimet kohore për vlerësimet, me po të njëjtin Ligj në nenin 20 përcaktohet se “1. Duke iu nënshtruar

paragrafit 2. të këtij neni, të gjitha tatimet duhet të vlerësohen brenda gjashtë viteve nga data kur deklarata tatimore me të cilën lidhet vlerësimi ka qenë obligues, apo datën kur është paraqitur deklarata, cilado qoftë më e vona, dhe paragrafi 2. Drejtori i Përgjithshëm mund të bëjë vlerësimin në çdo kohë në rastin kur: 2.1. një person, nuk ka dorëzuar deklaratën tatimore 2.2. një person, me synim të shmangies së tatimeve, ka dorëzuar një formular tatimor; apo 2.3. sjellje mashtruese e një personi të tretë ka çuar në nën-raportimin e tatimit apo mbi raportimin e kreditimeve.”

Udhëzimi Administrativ nr.15/2010 për zbatimin e ligjit nr. 03/l-222 mbi administratën tatimore dhe procedurat Neni 17, “*Kërkesa për Libra dhe Regjistrime, paragrafi 11. Të gjithë librat dhe regjistrimet e kërkuara të përshkruara në paragrafët 1 deri 7, të këtij neni, duhet të mbahen për një periudhë deri 6 (gjashtë) vjeçare. Regjistrimet që lidhen me pasuritë që janë të zhvlerësueshme gjatë një periudhe prej më shumë se gjashtë vjet, duhet të mbahen për jetëgjatësinë e zhvlerësueshme të pasurive, plus një vit shtesë. Regjistrimet e lidhura me pasuritë që kërkojnë përcaktimin e bazës për trajtimin e fitimeve kapitale apo përcaktimin e fitimit më shitjen e tyre duhet të mbahen deri sa pasuritë e tilla të jenë shitur apo ekspozuar me plus 6 vite shtesë. Librat dhe regjistrimet duhet të mbahen në një mënyrë të renditur që ndihmon përpilimin e tyre në raportet përmbledhëse si dhe të ndihmojnë rishikimin dhe ekzaminimin nga ATK.”*

Nga administrimi i vendimeve të Doganës, gjykata konstaton se Dogana e Kosovës duke vepruar në rivendosje sipas udhëzimeve nga Gjykata me aktgjykimin A.nr.33/2014, ka lejuar kthimin e mallit të ndaluar përkohësisht-Arit në sasi prej 1,628.34 gram për subjektin në procedurë këtu paditësin. Nga arsyetimi i të njëjtit vendim, konstatohet se Dogana e Kosovës pas krahasimit të të dhënave nga ana e subjektit i ka rezultuar se sasia e deklaruar e arit nga lista e stokut e datës 20.10.2016 rezulton të jetë 16,265.17 gram ari, ndërsa stoku në datën e kontrollit ka qenë 11.093.38 gram e që për Doganën ka rezultuar se ka ndryshim të gjendjes prej 3,543.18 ari dhe të njëjtën e ka konsideruar si shitje e padeklaruar duke konstatuar se lënda duhet të trajtohet nga ana e ATK-së për procedurat e mëtutjeshme.

Gjykata konstaton se pavarësisht se e paditura informatat i ka pranuar nga Dogana gjatë procedurës së rishqyrtimit të vendimit të së njëjtës, e njëjta nuk ka provuar se veprimet sipas informatave të pranuar janë të bazuar në ligj, kjo për faktin se sipas dispozitave të lartcekura, ri-kontrolli i të paditurës ka qenë dashtë të jetë i autorizuar nga Drejtori i ATK-së dhe po ashtu

gjykata konstatoon se e paditura nuk e ka respektuar kufizimin e afatit të rikontrollit konform nenit 20 të ligjit 03/-222, meqenëse të njëjtin e ka ndërmarr pas kalimit të afatit gjashtë vjeçar. Pretendimet e të paditurës se neni 19, par.11.1 i përjashton kufizimet kohore të parapara në nenin 20, gjykata i vlerëson si të paqëndrueshme dhe interpretim jo i drejtë i të njëjtit.

Bazuar në nenin 81.F par.2 të ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L222 se: *“Administrata tatimore, doganore ose ndonjë administratë tjetër kompetente do të bart detyrimin e vërtetimit të fakteve të cilat e mbështesin vendimin dhe kundërshtojnë kërkesën e tatimpaguesit”*. Neni 7 Parag 1 dhe 3 i Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 parasheh se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë me të cilat konstatohen faktet e tilla,”*. Nga këto dispozita Gjykata konsideron se përdorimi i mjeteve dhe metodave të provuarit, nënkupton një detyrim për palët dhe respektimin e procedurave ligjore të përcaktuara me ligj.

Rrjedhimisht, Gjykata konform nenit 46 par 4 me të cilin përcaktohet se *“Kur gjykata konstatoon se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet, mundet, nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, me aktgjykim të vendosë për çështjen administrative. Aktgjykimi e zëvendëson aktin e anuluar,”* vendosi që të aprovoj kërkesëpadinë e paditësit dhe të anuloj vendimin e kontestuar, ndërsa vendimin lidhur me obligimin si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi me të cilin e paditura obligohet të kthejë mjetet e paguara nga paditësi, Gjykata e mori konform nenit 46 par 5 me të cilin përcaktohet se *“Me aktgjykim, me të cilin anulohet akti i kontestuar administrativ, gjykata do të vendosë edhe për kërkesën e paditësit për kthimin e sendit, respektivisht për kompensimin e dëmit, nëse të dhënat e procedurës japin për këtë gjë bazë të sigurt. Në të kundërtën, gjykata do ta udhëzojë paditësin që kërkesën e vet ta realizojë në procedurën kontestimore.”*

Vendimi për kamatë në shumën e detyruar si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e mori duke aplikuar dispozitën e nenit 57.4 të Ligjit nr.2044/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, me të cilën përcaktohet se *“Në qoftë se lënda për të cilën është bërë ankesë, është zgjidhur përfundimisht në favor të tatimpaguesit, ATK do t'i kthejë çdo tatim të paguar tepër, së bashku me interesin e llogaritur në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Financave dhe ekonomisë në lidhje me secilin muaj kalendarik në mes të datës*

së pagesës nga tatimpaguesi dhe datën kur ATK i referon për pagesë rimbursimin Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë” dhe dispozitën e nenit 82 par.4 të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, ku është paraparë se “Në qoftë se lënda për të cilën është bërë ankesë, është zgjidhur përfundimisht në favor të tatimpaguesit, ATK do t’i kthejë çdo tatim të paguar tepër, së bashku me interesin e llogaritur në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave në lidhje me secilin muaj kalendarik në mes të datës së pagesës nga tatimpaguesi dhe datën kur ATK i referon për pagesë rimbursimin Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”.

Vendimin lidhur me shpenzimet procedurale, Gjykata e ka marr konform nenit 64, të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative me të cilin shprehimisht përcaktohet se në procedurën e konfliktit administrativ secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Nga të cekurat më lart, Gjykata konform nenit 43, par 1 dhe nenit 46 par. 1, 2, 3, 4, dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.187/22, datë 22.03.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.